# DËSHMI ARKIVI

**A-471194**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Mbyllim kapitujt brenda vitit 2027”, Fino: Sfida më e madhe “Themelorët” dhe siguria ushqimore |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/mbyllim-kapitujt-brenda-vitit-2027-fino-sfida-me-e-madhe-themeloret-dhe-i588516` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 10:52:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 11:40:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `44321d4cef0925040b0fb2160068cb3dd38ba8b95c6786a6afe895701de1700e` |
| TEKSTI | `88830711c53b17173fae638ed3036eb75acae5440822ae3591856d08b705c184` |
| PAMJA | `eb48c6984cdd5cb238e66876c1b505b7860bb954e52c51ce68c346b684323d28` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `849063a1c7a440cfba529be2ce57fd0d4e6fd5393326b5d875044d93eae2708b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `2f94de55f91080d406fb9f0e4354ffa5a46214db9e0928186c4866f36bf6cd6f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/849063a1c7a440cfba529be2ce57fd0d4e6fd5393326b5d875044d93eae2708b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "Mbyllim kapitujt brenda vitit 2027", Fino: Sfida më e madhe "Themelorët" dhe siguria ushqimore

TemA
26 Shtator 2026, 13:40Politika TEMA




Brukseli zyrtar e shikon pozitivisht punën që Shqipëria po bën sa i përket negociatave për Bashkimin Europian. Për Vizion Plus, zv.ministrja e Jashtme Megi Fino, shprehet se mbyllja e tre grupkapitujve të parë ishte vetëm fillimi, ndërsa Tirana zyrtare pret sinjalin e radhës.

*"Padyshim që mbyllja e tre kapitujve në korrik të këtij viti nuk ishte një rast i vetëm. Sigurisht që ne presim që do të ketë edhe raste të tjera që padyshim me këtë ritëm dhe në kuadër të këtij plani pune që kemi dakordësuar me Komisionin Europian", u shpreh Fino.*

Ajo thekson se mbajtja e këtij ritmi aktual mund të bëjë të mundur arritjen e objektivit për të mbyllur të gjithë grupkapitujt brenda vitit 2027, synim ky i dakordësuar edhe me Komisionin Europian.

*"Kemi parë që në më pak se dy vjet, janë hapur të gjithë grupkapitujt, janë mbyllur tre kapituj, tanimë kemi bërë progres edhe me piketat e ndërmjetme. Puna vazhdon, është e përditshme, jo vetëm për ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, është një punë që i përket të gjithë qeverisë shqiptare dhe administratës. Pikë së pari padyshim për ne është mbajtja e këtij momentumi apo këtij ritmi dhe këtij angazhimi që ne e kemi maksimal. Vullneti i qeverisë është maksimal", thotë Fino.*

Por cilët sektorë janë më sfiduesit për vendin tonë? Zv.ministrja Fino rendit disa prej tyre nga "Themeloret" e deri tek "Siguria Ushqimore".

*"Mund të përmendja grupkapitullin e themeloreve. Padyshim kapitujt 23 dhe 24 i cili vendos dhe ritmin pak a shumë të të gjithë kornizës negociuese sepse është grupkapitulli që hapet i pari dhe mbyllet i fundit. Padyshim që për sa i përket kapitujve të bujqësisë dhe zhvillimit rural apo sigurisë ushqimore apo mjedisi. Janë tema dhe janë sektorë të rëndësishëm të cilat prekin dhe kërkojnë kapacitete të shumta në nivel qendror por edhe vendor", thotë ajo.*

Në korrik, vendi ynë zhvilloi konferencën ndërqeveritare BE-Shqipëri, ku u mbyllën 3 kapitujt e parë, "Shkenca dhe Kërkimi", "Arsimi dhe Kultura" si dhe "Marrëdhëniet me Jashtë".

---

## Lini një Përgjigje

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[VIDEO/ Eric Wendt mbërrin në Pallatin e Brigadave për ceremoninë e nisjes së mandatit si Ambasador i SHBA në Tiranë]

11:23 Politika

[Tabaku: Korrupsioni është taksa e fshehtë që paguan çdo shqiptar]

09:30 Politika

[Eric Wendt nis sot misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri, do t'i dorëzojë letrat kredenciale Begajt]

08:30 Politika / 3 komente

[Fjala e PLOTË/ Edi Rama në OKB: Makineria e Inteligjencës Artificiale do të bindet, pyetja është 'kujt']




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.